



Prishtinë: 12.02.2020
Kodi i ZRRE-së: V_1232_2020

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2007_12_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **06.01.2020**.

në seancën e mbajtur më datë 12.02.2020, nxori këtë:

V E N D I M

- I REFUZHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin R. J. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR - 90111259 si e pa bazuar.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_2007_12_19** i datës 10.12.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 06.01.2020 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: faturimi i periudhës 04/2016 është faturim i saktë dhe paraqet shpenzim real, dhe se korrigjimi i bërë me datë 14.07.2016 paraqet shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 11/2015 – 04/2016. Konsumatori në ankesë ka theksuar se shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike është bazuar në Pëlqimin Elektroenergjetik të datës 28.12.2016 për periudhën 6 mujore dhe kjo bazuar në shpenzimin më të lartë të periudhës dimërore. KESCO në ankesë ka theksuar se nuk pajtohet me DMK në ZRRE për shpërndarje prej 05/2015 – 04/2016 bazuar në shpenzimin mestar mujor 09/2016 – 04/2017. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK_V_2007_12_19 i datës 10.12.2019 për konsumatorin R. J. me shifër DPR – 90111259.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuar nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se faturimi i periudhës 04/2016 është faturim i saktë dhe paraqet shpenzim real, dhe se korrigjimi i bërë me datë 14.07.2016 paraqet shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 11/2015 – 04/2016, Bordi i ZRRE-së thekson gjatë analizave të bëra të gjitha shkresave të lëndës konstaton se vendimi i organit të shkalës së parë është vendim i



saktë dhe i drejtë dhe i bazuar në argumente konkrete. Ashtu siç është theksuar edhe në vendimin e DMK të ZRRE si organi i shkallës së parë, periudha e shpërndarjes së shpenzimit prej 11/2015 deri më 04/2016 nuk përputhet me Pëlqimin Elektroenergjetik që i është lëshuar investitorit për kyçjen e objektit në rrjetin elektrik ku e cila ka qenë 28.12.2016, madje nuk përputhet me datën e faturës 04/2016. Bordi i ZRRE thekson se bazuar edhe në analizën e bërë shpenzimit të energjisë elektrike vërtetohet qartë se konsumatori në periudhën kontestuese 04/2016 ka dallim të madh krahasuar me të gjitha periudhat e njëjta kohore, me çka edhe vërtetohet se shpenzimi i energjisë elektrike (kWh) të faturuara për periudhën prill 2016 nuk mund të paraqes shpenzim real mujor të konsumatorit, përkatësisht paraqet kWh të grumbulluar nga periudhat e mëhershme.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike është bazuar në Pëlqimin Elektroenergjetik të datës 28.12.2016 për periudhën 6 mujore dhe kjo bazuar në shpenzimin më të lartë të periudhës dimërore, Bordi i ZRRE thekson se bazuar në të dhënat e evidentuara në procesverbalin për pranimin e instalimit elektrik nr.0085666 të datës 25.03.2016 vërtetohet se njehsori elektrik nr.64103833 me gjendje TL=5411 kWh dhe TU=1479 kWh i konsumatorit ka pasur të regjistruara shpenzime me çka edhe vërtetohet se konsumatori ka qenë i kyçur në rrjetin elektrik para pranimit teknik të njehsorit, dhe se ashtu siç u theksuar edhe më lartë shpenzimi i periudhës 04/2016 paraqet grumbullim të shpenzimit të periudhave të mëherëshme. Bordi i ZRRE-së gjithashtu thekson se bazuar në shkresat e lëndës ka vërejtur se KEDS nuk ka dhënë asnjë arsytim se pse është marrë periudha e shpërndarjes së shpenzimit prej 11/2015 deri më 04/2016, kur shihet se Pëlqimi Elektroenergjetik që i është lëshuar investitorit për kyçjen e objektit në rrjetin elektrik ka qenë 28.12.2016, e që nuk përputhet me datën e faturës 04/2016 dhe as me periudhën e shpërndarjes së shpenzimit. Madje edhe shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike e bërë nga KESCO për periudhën 11/2015 deri më 04/2016 nuk përputhet me shpenzimin e energjisë elektrike të periudhave tjera.

Bordi i ZRRE ka analizuar me kujdes shpenzimin e energjisë elektrike të konsumatorit edhe pas periudhës 04/2016, dhe gjatë analizës së bërë shpenzimit të energjisë elektrike konstatohet se konsumatori ka lexim të rregullt të shpenzimeve mujore. Bazuar në këto analiza Bordi i ZRRE-së thekson se faturimi i kWh në periudhën kontestuese prill 2016 nuk paraqet shpenzim real mujor të konsumatorit. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike mbi shpenzimet e konsumatorit për periudhat e njëjta kohore të mëvonshme vërtetohet se: periudha 04/2017 është 425 kWh, periudha 04/2018 është 300 kWh, si dhe periudha 04/2019 është 859 kWh. Po ashtu Bordi i ZRRE konstaton se mesatarja mujore e shpenzimeve të konsumatorit nga fillimi përkatësisht periudha 05/2016 deri në periudhën 10/2019 është 465.30 kWh/muaj, si dhe mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 09/2016 deri më 04/2017 prej 659.00 kWh/muaj. Bazuar në këto analiza vërtetohet se konsumatori në periudhën kontestuese 04/2016 ka dallim të madh krahasuar me të gjitha periudhat e njëjta kohore me çka edhe vërtetohet se shpenzimi i energjisë elektrike (kWh) të faturuara për periudhën prill 2016 nuk mund të paraqesin shpenzim real mujor të konsumatorit, përkatësisht paraqesin kWh të grumbulluar nga periudhat e mëhershme.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se nuk pajtohet me DMK në ZRRE për shpërndarje prej 05/2015 – 04/2016 bazuar në shpenzimin mestar mujor 09/2016 – 04/2017, Bordi i ZRRE-së thekson se ka analizuar me kujdes të gjitha shkresat e lëndës dhe ka vërejtur se bazuar në Pëlqimin Elektroenergjetik (PEE) nr.1160 të datës 28.12.2015 është vërejtur se investitori para këtij Pëlqimi ka pasur edhe PEE nr.7321 të datës 09.09.2015. Pra nga kjo shihet qartë se konsumatori i ka skaduar PEE i parë nr.7321 i datës 09.09.2015 dhe është dhënë prapë PEE nr.1160 i datës 28.12.2015 me disa ndryshime. Lidhur me këtë shihet qartë se te konsumatori në fjalë ka ekzistuar edhe një PEE tjetër nga ai me të cilën është bërë pranimi i njehsorit elektrik nr.64103833. Lidhur me këtë Bordi i ZRRE thekson se nëse do të ishte bërë shpërndarja e shpenzimit të energjisë elektrike për konsumatorin për



periudhën prej 09/2015 deri më 04/2016 do të rezultonte se mesatarja mujore e shpenzimit të energjisë elektrike për këtë periudhë do të ishte 1,001.38 kWh/muaj e që nuk përputhet me mesataren e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën pas kontestit 05/2016 – 10/2016 e cila ka qenë 465.30 kWh/muaj, apo nuk përputhet as me mesataren mujore të shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 09/2016 deri më 04/2017 prej 659.00 kWh/muaj. Andaj Bordi i ZRRE bazuar në analizat e bëra të gjitha shkresave të lëndës konstaton se vendimi organit të shkallës së parë të ZRRE ku është kërkuar që të bëhet korrigjimi i faturës nr.04160DPR-90111259 për periudhën 12 mujore në vlerë - **69.42€** duke bërë shpërndarjen e kWh për periudhën 05/2015 deri në periudhën 04/2016 është vendim i drejtë dhe i saktë.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 12.02.2020 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit R. J. dhe
- Arkivit të ZRRE-së